



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 07.10.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.2) të Rregullores për Prokurim Publik Nr.001/2022 ,e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 20.01.2026, të parashtruar nga Operatori Ekonomik " MBB Construction " SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit "Renovimi i objektit të N.P.L. Stacioni i autobusëve Gjakovë faza-II-të", Nr. i prokurimit- 632-25-8206-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-104-521, nxjerr:

V E N D I M

- 1. Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik " MBB Construction " SH.P.K., e dt.20.01.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Renovimi i objektit të N.P.L. Stacioni i autobusëve Gjakovë faza-II-të", Nr. i prokurimit- 632-25-8206-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-104-521, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të publikuar me datë 16.01.2026, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
- 2. Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë:16.01.2026;
- 3.Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit .
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

Arsyetim

Operatori Ekonomik " MBB Construction " SH.P.K., me dt.20.01.2026, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit "Renovimi i objektit të N.P.L. Stacioni i autobusëve Gjakovë faza-II-të", Nr. i prokurimit- 632-25-8206-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-104-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 27.01.2026, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimet e juaja janë të pa bazuara, sepse Autoriteti kontraktues ka caktuar një afat(dt.29.12.2025, ora 16:00) kur ju duhet të dorëzoni sqarimet shtesë që ju janë kërkuar. Ju këto sqarime i keni dorëzuar me vonesë me dt.29.12.2025 ora 20 :08;

Autoriteti kontraktues ka vepruar në pajtim me nenin 5 të LPP-së:

"Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit. Autoriteti kontraktues mund të vendosë që të caktojë një kohë tjetër me kusht që ai është jo më herët se në ora 12:00 të ditës së skadimit."

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

